

**MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN ARMEN**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Armen, Qarku i Vlorës**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 68, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 239/6, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Kliton Haxhiraj, Kryetar i komunës Armen, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetjet nga auditimi:

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 402/6 prot. datë 2.2.2011, u konstatua se disa rekomandime nuk janë zbatuar plotësisht ose janë në proces zbatimi. Konkretisht:

-nga 9 masa organizative, në të cilat për 5 masa organizative, është kërkuar vjelja e detyrimeve debitore për taksa dhe tatime prej 1860 subjekte juridike dhe persona fizikë në shumën 19,873,500 lekë, janë zbatuar plotësisht 3 masa organizative dhe pjesërisht 1 masë. Janë pa zbatuar 5 masa organizative lidhur me mos arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën 19,873,500 lekë.

1.1.Rekomandimi:

Bashkia Selenicë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të pa zbatuara plotësisht për;

- 5 masat organizative me vlerë **19,873,500 lekë**.

Menjëherë

2.Gjetjet nga auditimi:

Kryetari i Komunës dhe stafi drejtues, nuk kanë patur njohuri mbi komponentët e MKF-së, duke mos gjetur zbatim në të gjitha hallkat e tij. Mungon hartimi i planit strategjik, për ngritjen e sistemit të MFK dhe menaxhimin e riskut, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të UMF nr 30, datë 27.10.2011 për MFK

2.1.Rekomandim:

Të merren masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i Bashkisë Selenicë(ku është përfshirë komuna Armen, këtu e poshtë do të quhet Njësi Vendore e Shkrirë (NJVSH), të ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Menjëherë

3.Gjetjet nga auditimi:

Nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e funksionimit të brendshëm të administratës, ku të jenë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion, që nga niveli drejtues e deri tek niveli më i ulët i punonjësve për çdo sektor, për rregullat e komunikimit dhe për raportimin e aktivitetit, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 32/ç të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3.1.Rekomandim:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, në përputhje me strukturën organike, duke implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kodin etik për këtë njësi të re administartive.

Brenda muajit Korrik 2015

4. Gjetjet nga auditimi:

Mungojnë programet financiare afatmesme, ku të jenë përfshirë plani strategjik i zhvillimit, të jetë përcaktuar misioni, qëllimet, objektivat e PBA si dhe politikat për çdo program, treguesit sasiorë lidhur me të ardhurat dhe shpërndarjen e shpenzimeve, dokumentimin e risqeve, produktet e programit si dhe efektet financiare. Nuk ka detajim analitik që në planifikim të artikullit të shpenzimeve operative, në kundërshtim me pikat 100 e 101 të kapitullit II. 3 të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar. Mungojnë analiza e realizimit të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe miratimi nga Këshilli i Komunës i buxhetit faktik, në kundërshtim me nenin 19, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

4.1.Rekomandim:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa për ngritjen e një grupi pune (GMS), që të kryejë hartimin e programit të zhvillimit ekonomik afatmesëm. Projekt programet ekonomike, të hartohen dhe të paraqiten në afat. Të bëhen raportime periodike dhe vjetore të shoqëruara me analizën e realizimit të buxhetit faktik dhe të miratohen në Këshillin e Bashkisë.

Brenda muajit Shtator 2015

5. Gjetjet nga auditimi:

Në auditimin e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, u konstatuan mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: kërkesat për përcaktimin e nevojave për blerje, argumentimi i fondit limit, mungesë të urdhrin të prokurimit, mungesë të dokumentit të raportit kualifikimit final të miratuar nga Kryetari i AK, mungesë e aktit të marrjes në dorëzim, në kundërshtim me pikën 2/a, Kreu i VI, i VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar, me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33 datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarte të

auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, tabela 1/3 dhe pikat 37, 42, 43 dhe 44 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011”.

5.1.Rekomandim:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa, për hartimin e gjurmëve standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave, deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga titullari.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit të aktiveve, u konstatua se janë nxjerr jashtë përdorimit inventarë; për vitin 2013 në shumën 639,702 lekë dhe për vitin 2014 në shumën 352,525 lekë. Për këto janë bërë veprimet kontable, por nuk është bërë rivlerësimi, ose asgjësimi i tyre me procesverbal, në kundërshtim me pikën 109 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6.1.Rekomandim:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa dhe të procedojë, sipas kërkesave ligjore për inventarët të nxjerra jashtë përdorimi, duke kryer procesin e tjetërsimit apo të asgjësimit, të shoqëruara me veprimet kontabël përkatëse.

Menjëherë

7. Gjetjet nga auditimi:

Në të gjithë proceduarat e prokurimit publik(tenderët), Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk ka siguruar ndarjen e detyrave për nëpunësit e përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit, në kundërshtim me kërkesave të kreut V, pika 1/a, 2/a të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nenet 15, 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiarë dhe kontrollin”.

7.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), ku Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë) të sigurojë, ndarjen e detyrave për të gjithë nëpunësit e përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit, gjatë fazës së zhvillimit të prokurimeve.

Menjëherë

8. Gjetjet nga auditimi:

Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka kryer kontrole në subjektet taksa pagues, mbi lëshimin ose jo të kuponëve tatimore, mbi mbajtjen e librave të xhiros etj., veprime këto në kundërshtim me kërkesat e pikës 10 të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

8.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), ku Zyra e Taksave e Tarifave Vendore e Bashkisë Selenicë, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontroleve në drejtimet e përcaktuara sipas kërkesave

të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007, në bashkëpunim me Policinë e Bashkisë.

Në vijimësi

9. Gjetjet nga auditimi:

Në këtë Komunë, për vitet 2013 dhe 2014, kanë ushtruar aktivitetin e tyre 24 subjekte të biznesit të vogël, të pa regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), të cilat nuk kanë paguar taksat lokale në shumën **1,197,000 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e nenet 40, 41 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

9.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masat e nevojshme ligjore, me qëllim regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 1,197,000 lekë nga 24 subjektet e pa regjistruara.

Menjëherë

10.Gjetjet nga auditimi:

Konstatohet se për vitet 2013 dhe 2014, kanë ushtruar aktivitet pa qenë të regjistruar, 36 subjekte taksa pagues. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, llogaritur në vlerën 3,227,532 lekë, shkelje këto të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe 41, ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar .

10.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), ku Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë e Bashkisë, të marrë masa dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore në vlerën **3,227,532 lekë**, nga 36 subjekte që kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar, sipas listës emërore të pasqyrës në faqen 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shtator 2015

11.Gjetjet nga auditimi:

Është konstatuar se deri më datën 31.3.2015, nuk është arkëtuar vlera 49,961,000 lekë, për 2 lloje taksa të popullatës përkatësisht; taksa për ndërtesën për 1248 familje në vlerën 1,074,000 lekë, taksë toke për 1663 familje për vlerën 48,887,000 lekë.

11.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), pra Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë, të marrin masa dhe të ndjekin hapat ligjorë e administrativ, për arkëtimin nga debitorët të vlerës **49,961,000 lekë**, si diferencë e pa paguar për taksat dhe tarifatat nga banorët e ish komunës Armen.

Brenda muajit Dhjetor 2015

12.Gjetjet nga auditimi:

Zyra e Taksave Vendore, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga subjekte të biznesit të vogël të vlerës debitorë për 303,375 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nenet 89, 90 dhe 91 .

12.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), pra Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë, të marrin masa dhe të ndjekin hapat ligjorë e administrativ për arkëtimin nga subjektet taksa pagues, të detyrimeve debitorë për vlerën **303,375 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2015

13.Gjetjet nga auditimi:

Me VKM nr. 589, datë 14.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Armen të Qarkut Vlorë”, është miratuar për Komunën Armen lista e pronave pyje dhe kullota. Sipas këtij vendimi Komuna Armen, ka marrë në dorëzim 789,3 ha sipërfaqe pyjeve dhe kullota, por kjo nuk është shoqëruar me inventarizimin e tyre në terren, mbi gjendjen e statusit juridik të tyre. Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 804, datë 4.6.2008, mbi “Dorëzimin e fondit pyjor dhe kullor”, nenet 24, 25 të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenet 9, 10, 11, 13 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe neni 30, 35/a, 73 të UMF nr. 30 datë **27.12.2011** “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

13.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të kryej inventarizimin fizik dhe ligjor mbi gjendjen e statusit juridik të **789,3 ha** sipërfaqe pyjeve dhe kullota, të cilat me VKM nr. 589, datë 14.5.2008, të cilat janë transferuar në pronësi të ish komunës Armen.

Brenda muajit Shtator 2015

14.Gjetje nga auditimi:

Nga komuna Armen, nuk janë kryer procedurat e nevojshme ligjore për regjistrimin në ZRPP Vlorë, në pronësi të komunës, të pronave që me VKM nr. 589, datë 14.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Armen të Qarkut Vlorë” dhe VKM nr. 1585, datë 3.12.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore në komunën Armen, të Qarkut Vlorë”, kanë kaluar në pronësi të saj.

Në këtë rast, mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenet 7, 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar, neni 6 i ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar dhe nenet 24, 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”.

14.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), , e cila të marrë masat e nevojshme, për përgatitjen e dokumentacionit të

nevojshëm tekniko ligjor, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të saj.

Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetjet nga auditimi:

Nga Komuna, nuk janë marrë masat e nevojshme për menaxhimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kulllosore:

Në strukturën organike të komunës, nga viti 2014 e në vazhdim, nuk është parashikuar punonjës për mbrojtjen e tyre;

Nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenin 5, 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, neni 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kulllosor” i ndryshuar dhe pika 5/dh e VKM nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”.

15.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, të hartojë planin e mbarështimit, administrimit dhe ruajtjen e sipërfaqeve pyje dhe kullota.

Brenda muajit Dhjetor 2015

16. Gjetjet nga auditimi:

Nuk janë miratuar me vendim të Këshillit të Komunës, pronat të cilat me VKM nr. 1585, datë 3.12.2008, kanë kaluar në pronësi të Komunës Armen, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 9, 10, 13 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe neni 32 i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

16.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), pra ZMMT të paraqesë në Këshillin e Bashkisë, dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor për miratimin e pronave që me VKM nr. 1585, datë 3.12.2008, kanë kaluar në pronësi të Komunës Armen, në zbatim të kërkesave të neni 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000.

Brenda muajit Dhjetor 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 32,362,900 lekë** në mënyrë analitike, si më poshtë:

1.Gjetjet nga auditimi:

Subjekti sipërmarrës i kryerjes së punimeve të objektit të prokuruar: “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen” “B-....” shpk, ka përfutuar padrejtsisht,

shumën **8,341,730 lekë pa T.V.SH** me dëm ekonomik buxhetit të shtetit, nga të cilat:

-8,341,730 lekë, diferencë çmimi nga ndryshimi i zërave të punimeve.

1.1.Rekomandimi:

Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti “B-....” sh.p.k. për **8,341,730 lekë pa T.V.SH**, të përfituara padrejtësisht.

Brenda muajit Shtator 2015

2.Gjetjet nga auditimi:

Hartuesit e projekt- preventivit të objekti të prokuruar: “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen”, kanë përgatitur preventivin e fondit limit me vlerën **20,475,686 lekë pa TVSH më tepër**, në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe manualin teknik të çmimeve në fuqi nga të cilat, **vlera 10,248,519 lekë pa TVSH (20,475,686-10,227,167) përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit. Veprime këto në kundërshtim me pikat 2, 3 dhe 9 të VKM Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

2.1.Rekomandimi:

Të shlyhet vlera e dëmit për **10,248,519 lekë** nga hartuesit e projektit dhe preventivit të objektit “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen”, përkatësisht nga:

-*znj. Y.Y për 5,124,259 lekë,*

-*z. K.SH për 5,124,259 lekë.*

Brenda muajit Shtator 2015

3.Gjetjet nga auditimi:

Bashkimi i operatorëve “Xhodi Construction” dhe “B-93” sh.p.k, kanë përfituar për punime të pa kryera në objektin “Ndërtimi i rrugës Rromës- Karbunarë”, **shumën 6,176,600 lekë pa TVSH, me dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kërkesat ligjore.

3.1.Rekomandimi:

Të kërkohet arkëtimi i dëmit për **6,176,600 lekë** nga bashkimi i operatorëve “XH....C...” dhe “B.....” shpk, të cilët kanë përfituar padrejtësisht.

Brenda muajit Korrik 2015

4.Gjetjet nga auditimi:

Konstatohet se deri më datën 31.12.2014, nuk është arkëtuar **vlera 1,296,900 lekë**, për buxhetin e komunës, për tarifën e ujit të pijshëm nga 392 familje, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Komunës nr. 1, datë 04.02.2013 “Për miratimin e tarifës së ujit të pijshëm”, kontratën tip “Për furnizimin me ujë të pijshëm” dhe nenit 850 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

4.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa dhe të ndjekë hapat ligjore e administrative për arkëtimin e vlerës debitore, në shumën **1,296,900 lekë** nga 392 konsumatorë familjarë.

Brenda muajit Tetor 2015

5.Gjetjet nga auditimi: Në këtë komunë, për vitet 2013 dhe 2014, kanë ushtruar aktivitetin e tyre 36 subjekte, të cilat janë pajisura nga Komuna Armen me

certifikatë transporti për nevojat e veta por që nuk janë regjistruar në QKR. Për rrjedhojë, këto subjekte nuk kanë paguar detyrimet për taksën e biznesit të vogël në shumën **980,000 lekë** për buxhetin e komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime dhe nenit 30 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshime.

5.1.Rekomandimi:

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masat e nevojshme ligjore, me qëllim regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet transport mallrash për nevojat e veta, pa qenë të regjistruara në QKR dhe të kërkojë arkëtimin e shumës **980,000 lekë** nga 36 subjekte.

Brenda muajit Dhjetor 2015

6.Gjetjet nga auditimi:

Komuna Armen nuk ka arkëtuar vlerën e sigurimit të ofertës nga OE “G.... Nd...” shpk në shumën **517,307 lekë**, e cila është tërhequr nga procedura e tenderit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Romës Karbunarë”. Ky mos veprim është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 49, germa “i” dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, germa “e”, pika 2, kreu III.

6.1.Rekomandimi: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen) e cila, të bëjë kërkesë padi në gjykatë dhe të ndjekë në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës së sigurimit të ofertës të OE “G..... Nd...” shpk, në shumën **517,307 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2015

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatua se në 1 rast ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **6,098,744 lekë pa T.V.SH.** Vlerë kjo që përcaktohet në objektin: Në tenderin me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Romës Karbunarë”, është skualifikuar bashkimi i OE “C.....R..... ” dhe “SH.....M” shpk me vlerë të ofertës më të vogël se subjekti OE “B-93” shpk i shpallur fitues, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Ky rekomandim do të implementohet nga bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Armen), e cila të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë nga tre anëtarë e KVO, përkatësisht (z. A.H, z. TH.M vlera dhe z. NJ.H), për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për një procedurë prokurimi me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **6,098,744 lekë pa**

T.V.SH, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Brenda muajit Shtator 2015

C.MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë (ku është përfshirë ish komuna Armen), fillimin e procedurave administartive për dhënien e masës disiplinore, nga “*Vërejtje*” deri “*Ndërprerje të marrëdhënie të punës*”, sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta persona:

1. Z. Nj.H me detyrë Përgjegjës i Ujësjellësit dhe në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

-Për shkelje të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Romës Karbunarë”. Skualifikuar padrejtësisht bashkimi i OE “Xh... K.....” dhe “B....” shpk, me efekt financiar për vlerën **6,098,744 lekë** pa tvsh me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit të miratuara nga njësia e prokurimit, neni 46 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 2/d, 2/dh, 2/h, 3/c kreu III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

-Për mos vjeljen e detyrimeve kontraktore për furnizimin me ujë të pijshëm, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Komunës nr. 1, datë 04.02.2013, “Për miratimin e tarifës së ujit të pijshëm” dhe nenit 850 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Z.Artur Hysaj me detyrë Përgjegjës i Administratës dhe në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

-Për shkelje të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Romës Karbunarë”. Skualifikuar padrejtësisht bashkimi i OE “Xh..... K.....” dhe “B.....” shpk, me efekt financiar për vlerën **6,098,744 lekë** pa tvsh me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit të miratuara nga njësia e prokurimit, neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 2/d, 2/dh, 2/h, 3/c kreu III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

3. Z. TH.M me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

-Për shkelje të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Romës Karbunarë”. Skualifikuar padrejtësisht bashkimi i OE “XH..... K.....” dhe “B.....” shpk, me efekt financiar për vlerën **6,098,744 lekë** pa tvsh me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit të miratuara nga njësia e prokurimit, neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 2/d, 2/dh, 2/h, 3/c kreu III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

4. Z. V.S, me detyrë Inspektor i Zyrës së Taksave.

-Për mos zbatimin e procedurave ligjore për vjeljen e detyrimeve tatimore,

në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimit e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë”, i ndryshuar, neni 30, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Z. A. me detyrë Inspektor i Shërbimeve.

-Për dhënien e çertifikatave të transportit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë”, i ndryshuar, neni 30 i Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” i ndryshuar.

Shënim: Për z.K.H, ish kryetar i komunës Armen(NJVSH) për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit do të kërkonim masën shkarkim nga detyra, në kushtet kur ky person nuk ka më mandat në detyrën që ishte para datës 21.06.2015, kjo masë quhet e ezauruar.

D.1. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga auditimi i ushtruar në Komunën Armen, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, konkretisht:

1. A.H, Përgjegjës i Administratës të Komunës Armen.
2. TH.M, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës.
3. NJ.H, me detyrë Përgjegjës i Ujësjiellit.

-Për shkelje të rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt **“Rikonstruksion i rrugës Romës Karbunarë”**, zhvilluar në vitin 2013.

KVO, ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e OE “C.....y R....a” dhe “SH.....-M” shpk, pasi OE “C.....R.....a” shpk: “.... ka mangësi në dokumentacionin e mjeteve (fadroma e marrë me qira, nuk është shoqëruar me dokumentin e origjinës dhe fadroma e firmës tuaj nuk është shoqëruar me vërtetim zhdoganimi” , në kundërshtim me kriteret të veçanta të kualifikimit të miratuara nga njësia e prokurimit ku citohet: *“Pranohet marrja me qira ose hua përdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qiramarrjes ose huapërdorjes të jenë të lidhura para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt”*.

Skualifikimi ka sjellë efekt financiar në krahasim me vlerën e ofertës fituese bashkimi i OE “XH, K.....” dhe “B.....93” shpk, për shumën (25,503,478-19,434,734)= **6,098,744 lekë pa tvsh me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Skualifikimi është në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit të miratuara nga njësia e prokurimit, neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 2/d, 2/dh, 2/h, 3/c kreu III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

D.2. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga auditimi mbi hartimin e projekt dhe preventivit për objektin: “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen” të prokuruar në vitin 2013, u konstatuan shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, rekomandojmë Komisionin e dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet “Gjobë” deri në “Heqje e Licencës së ushtrimit të profesionit,” për:

- *znj.Y.Y në cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit*

- *z.K.SH në cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit*, pasi:

-Hartimi i preventivit nuk është bërë në përputhje me projektin e zbatimit, e konkretisht janë preventivuar volume pune më tepër se projekti i zbatimit si dhe janë vendosur çmime të zërave të punimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve në fuqi.

-Në këtë rast, është shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, në vlerën **10,248,519 lekë pa T.V.SH.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 3, Kreu I, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në pikat 2, 3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile, Pëparim Gjuzi, Irma Shkupi dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga znj. Mimoza Lloji kryeaudituese, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

